**VENDIM**
**Nr. 915, datë 29.12.2014**

# PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 23.4.2011, "Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve", dhe të nenit 11, të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 9, të vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet nënndarja me këtë përmbajtje:

"Punonjësve me rezultate të mira në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**